




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2910/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit ISPE, nr.ref.367/20H të datës 13.03.2020 dhe letra përcjellëse e datës 08.09.2020 kundër Vendimit të KSHC Nr. 146/20D të datës 11.02.2020 për mos akreditimin e programit Infermieri, Bsc, 180 ECTS, e pranuar më 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 5.11.2020, me shumicë votash, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit ISPE nr. Ref.367/20H e datës 13.03.2020 me letrën përcjellëse 1495/20H të datës 8.09.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së Nr. 146/20D i datës 11.02.2020.

ARSYETIM

Kolegji ISPE, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1495/20H të datës 08.09.2020, pranë Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të Programit të Studimit Infermieri, Diplomë e Përbashkët e ofruar midis Kolegjit ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda (SeAMK), kundër Vendimit Nr. Ref. 146/20D, datë 11.02.2020 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin Vendim është refuzuar kërkesa e BPrAL Kolegji ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda (SeAMK), Nr. Prot. 1136/19, datë 03.07.2019, për akreditim të Programit të studimit Infermieri, Diplomë e Përbashkët e ofruar midis Kolegjit ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda (SeAMK), me pretendimin e shkëljes së Udhëzimit administrativ për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë (MASHT) nr. 15/2018 të datës 28.09.2018 dhe paraqitjen e gabuar të fakteve sipas Raportit të Vlerësimit nga ana e

grupit të Ekspertëve në përbërje të Prof. Dr. Danica Zeleznik – kryetare dhe Znj. Delia Gologan – studente eksperte, të datës 3 Dhjetor 2019 të kontraktuar nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

KSHC, pas pranimit të raportit të ekspertëve ka konstatuar se raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit konstaton se nga gjithsej 7 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, Kolegji ISPE përmbushë substancialisht 2 standarde, pjesërisht 5 standarde, dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar mosdhënien e akreditimit.

Provat e administruara:

1. Raportin Final të Ekspertëve të Jashtëm të datës 03.12.2019 (i pranuar nga Kolegji ISPE dhe SeAMK me datë 02.03.2020);
2. Komentet e BPrAL Kolegji ISPE dhe SeAMK të datës 24.11.2019, në Raportin e Ekspertëve të Jashtëm;
3. Ankesën me numër protokolli 367/20H, të datës 13.03.2020, së bashku me Anekset e bashkangjitura në Ankesë, të parashtruar nga BPrAL Kolegji ISPE;
4. Ankesën me numër protokolli 1495/20H, të datës 08.09.2020, së bashku me Anekset e bashkangjitura në Ankesë, të parashtruar nga BPrAL Kolegji ISPE;
5. Vendimin e KShC-së, Nr. Ref. 146/20D, i datës 11.02.2020;
6. E-maili i datës 08.08.2019 i dërguar nga ish Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të AKA-së z. Avni Gashi;
7. E-maili i datës 18.08.2019 dërguar nga Leonis Gashi për AKA-në dhe Anëtarët e Bordit (KSHC-në);
8. E-maili i datës 19.08.2019 dërguar nga ish Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të AKA-së z. Avni Gashi drejtuar Kolegjit ISPE dhe SeAMK;
9. E-maili i datës 25.08.2019 dërguar nga znj.Helli Ketinjo për AKA-në dhe Anëtarët e Bordit të AKA-së;
10. E-maili i z.Arianit Krasniqi dërguar për Kolegjin ISPE dhe SeAMK me datë 09.09.2019;
11. E-maili i datës 16.09.2019 dërguar nga z.Shkelzen Gërxhaliu për Kolegjin ISPE dhe SeAMK;
12. E-maili datës 14.10.2019 dërguar nga Leonis Gashi për AKA-në;
13. E-maili i datës 21.10.2019 dërguar nga z.Shkelzen Gërxhaliu për Kolegjin ISPE dhe SeAMK;
14. E-maili i datës 21.10.2019 dërguar nga z.Arianit Krasniqi për Kolegjin ISPE dhe SeAMK;
15. E-maili i datës 21.10.2019 dërguar nga z.Arianit Krasniqi për Kolegjin ISPE dhe SeAMK, ora 04.00 PM (pasdite);
16. Letra e Kolegjit ISPE për Ushtruesin e Detyrës së Drejtorit të AKA-së z.Avni Gashi;

17. E-maili i datës 28.10.2019 dërguar nga znj. Ilirjana Ademaj-Ahmeti për Kolegjin ISPE dhe SeAMK;
18. E-maili i datës 29.10.2019 dërguar nga Kolegji ISPE për AKA-në;
19. E-maili i datës 12.11.2019 dërguar nga znj. Ilirjana Ademaj-Ahmeti për Kolegjin ISPE dhe SeAMK;
20. E-maili datës 15.11.2019 dërguar nga Leonis Gashi për AKA-në;
21. E-maili datës 24.11.2019 dërguar nga Leonis Gashi për AKA-në;
22. E-maili datës 10.12.2019 dërguar nga Leonis Gashi për AKA-në dhe Anëtarët e Bordit të AKA-së;
23. E-maili i datës 05.02.2020 i z. Shkelzen Gërxhaliu për Kolegjin ISPE;
24. Procesverbali i takimit të datës 07.02.2020 midis përfaqësuesve të Kolegjit ISPE dhe Bordit të AKA-së;
25. E-maili i datës 13.02.2020 nga Leonis Gashi për Anëtarët e Bordit të AKA-së;
26. E-maili i datës 24.02.2020 nga Leonis Gashi për Anëtarët e Bordit të AKA-së;
27. E-maili i Leonis Gashi për z. Arianit Krasniqi i datës 27.02.2020;
28. E-maili i z. Arianit Krasniqi për Leonis Gashi i datës 02.03.2020;
29. Kërkesa për ri-shqyrtim të Vendimit me nr protokolli 140/20 e datës 13.03.2020;
30. Kërkesa për takim e datës 16.03.2020;
31. Procesverbali i Takimit të datës 14.04.2020;
32. RVV e Kolegjit ISPE dhe SeAMK;
33. Marrëveshja e datës 18.06.2028 midis Kolegjit ISPE dhe SeAMK;
34. Marrëveshja e datës 04.12.2018 midis Kolegjit ISPE dhe SeAMK;

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr.ref.367/20H të datës 13.03.2020 dhe letrën përcjellëse të datës 08.09.2020 të Kolegjit ISPE, me datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Kolegji ISPE kundërshton Raportin e eksperteve, i cili ka rekomanduar mos akreditimin e programit të studimit Infermieri, Bsc, 180 ECTS, Diplomë e Përbashkët e ofruar midis Kolegjit ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Senajokit nga Finlanda (SeAMK).

Në anën tjetër, KSHC, për marrjen e vendimit është bazuar në Raportin e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga AKA për vlerësimin e programit Infermieri, Bsc, 180 ECTS të Kolegjit ISPE, i cili ka paraqitur se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit (Korrik 2018), ky program përmbushë substancialisht dy (2)

standarde dhe pjesërisht pesë (5) standarde. Po ashtu, ekipi i ekspertëve në fund të raportit ka rekomanduar që të mos akreditohet programi Infermieri, Bsc, 180 ECTS.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit ISPE për programin Infermieri, Bsc, 180 ECTS, Diplomë e Përbashkët e ofruar midis Kolegjit ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Senajokit nga Finlanda (SeAMK) është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos akreditimin e këtij programi.

Komisioni i Ankesave e ka shqyrtuar raportin e ekspertëve ndërkombëtarë, i cili nuk ka rekomanduar akreditimin e programit Infermieri, Bsc, 180 ECTS të Kolegjit ISPE, dhe ka vërtetuar se i njëjti nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit (Korrik 2018), ky program përmbushë substancialisht dy (2) standarde dhe pjesërisht pesë (5) standarde.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: *"Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendimin për akreditim ose mos akreditim."*

Nga kjo, mund të vërehet se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për përmbushjen e standardeve sipas Manualit të Akreditimit (Korrik 2018), i cili përcakton se: *"Për të marrë një vendim pozitiv për programin dhe ri-akreditimin institucional, çdo ofrues i arsimit duhet të demonstrojë të paktën një nivel të konsiderueshëm pajtueshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj, dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të pajtueshmërisë përfshinë vonimin, tërheqjen, pezullimin ose mohimin e akreditimit "*

Andaj, sipas nenit 18, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, Komisioni i Ankesave vlerëson se deri sa KSHC merr vendim bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve të jashtëm, atëherë Vendimi 146/20D, datë 11.02.2020, i KSHC-së ka bazë ligjore dhe arsyeshmëri të plotë.

Pala me datë 29.10.2020 dhe 2.11.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji ISPE e ka realizuar këtë të drejtë dhe ka mbrojtur të njëjtat pretendime si në ankesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2910/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.